



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dostezuar Primljeni/Prodato Received/Delivery	12.04.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMESHCK	3502/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.420/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.420/2023 të datës 24.02.2023 të parashtruar nga ankuesja

..... kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve në punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. ANULOHET Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022, i datës 19.12.2023, për ankuesen

II.OBLIGOHET Udhëheqësja e Drejtpërdrejtë e ankueses respektivisht Udhëheqësja e Divizionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi, duke bërë *ri-vlerësimin e rezultateve në punë* për ankuesen për periudhën nga data 01.01.2022 deri me datën 31.12.2022 në pajtim me legjislacionin në fuqi.

III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, që të ndërmarr veprimet që zbatimi i këtij vendimi të bëhet në si pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, fillimisht sipas Akt emërimit të datës 28.12.2018, në vendin e punës „Zyrtare e lartë Tatimor“ e cila sipas Vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm është transferuar në pozitën „Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Ndërkombëtar“, ndërsa me datë 31.12.2022 i është lëshuar Akt emërimi me numër protokoll 1714 për pozitën „Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Ndërkombëtar“. Ankuesja më datë me datë 19.12.2022 ka pranuar formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 nga Udhëheqësja e saj e drejtpërdrejtë, respektivisht nga Udhëheqësja e Divizionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare, me të cilin ankuesen e ka vlerësuar për periudhën janar-dhjetor të vitit 2022 me notën e përgjithshme 2.5 (dy pikë pesë).

Ankuesja e pakënaqur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022 ka shprehur mos pajtim lidhur me vlerësimin e rezultateve punës duke lënë komentin e saj se nuk pajtohet me vlerësimin e bere nga vlerësuesja, si dhe duke dhënë arsyet e saj lidhur me përmbushjen e objektivave, ndërsa Udhëheqësja es aj, deri me datën 03.02.2023 nuk i ka kthyer komentet e saj lidhur vlerësimin e punës për vitin 2022 për ankuesen.

Ankuesja e pakënaqur me vlerësimin dhe dorëzimin e vlerësimit përfundimtar pas komenteve nga ana e Udhëheqësës së Divizionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare-mbikëqyrëses së saj, me datën 24.02.2023 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 20691/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që vlerësimi i rezultateve të punës është bërë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore që përcaktojnë obligimet e mbikëqyrësit dhe procedurën e vlerësimit nga mbikëqyrësi, se vlerësimi është bërë pa mbajtur asnjë takim paraprak nga ana e mbikëqyrëses së saj, dhe se vlerësimi ndaj saj nga ana e mbikëqyrëses është jo real, tendencioz dhe në kundërshtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe dispozitat e Rregullores me numër Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave ligjore në fuqi me datën 07.03.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore të Kosovës, ndërsa me datën 10.03.2022 dhe 15.03.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore të Kosovës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 2069/2023 e datës 24.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2019; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2021; E-maili i datës 13.12.2022; Formuari për Përshkrim e Detyrave të Punës; Akt Emërimi i datës 28.12.2018; e-maili i datës 21.12.2022;Formulari për Përshkrimin e Detyrave të Punës; e-maili

i datës 09.03.2023; Përgjigje në ankesë e datës 10.03.2023. me numër protokollit 2554/2023; Përgjigje në ankesë e datës 15.03.2023. me numër protokollit 2704/2023 së bashku me Planin Individual të Punës për vitin 2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankueses të kthehet në rivlerësim, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022, nuk është objektiv dhe i pabazuar në prova dhe fakte, gjegjësisht vlerësimi i është bërë në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore, e cila ka shtuar se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 i është bërë pa pasur asnjë takim paraprak me mbikëqyrësen e saj të drejtpërdrejtë, nuk është nënshkruar formulari i vlerësimit si dhe formulari i vlerësimit për vitin 2022 nuk gjendet në dosjen personale të ankueses. Po ashtu, ankuesja thekson se formulari i vlerësimit përfundimtar pas komenteve të dhëna nga ankuesja nuk i është dorëzuar deri me datë 03.02.2022, e që është jashtë afatit të përcaktuar ligjor .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 pa pasur asnjë takim paraprak nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejt e saj, konkretisht pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se pretendimi është i qëndrueshëm sepse mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses me rastin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2022, ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, i cili përcakton se: *"Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesional të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: 1.1 takimi për diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura; 1.2 vlerësimin (notimi) e objektivave 1.3 konfirmimi i vlerësimit nga i vlerësuari."*, sepse vlerësimi i është dërguar ankueses në kundërshtim me nenin 4 të kësaj Rregullore, ku përcaktohet se: *"Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit"*, që në rastin konkret organi i punësimit nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ankuesja është kontaktuar nga Udhëheqësja e Divizionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare, për të diskutuar lidhur me periudhën e vlerësimit, dhe mbi këtë bazë ankuesja pasi ka pranuar vlerësimin, ka paraqitur me shkrim mospajtimin e saj, në pajtim me dispozitën e lartë cekura, dhe po ashtu në provat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi që mbikëqyrësja është takuar me ankuesen gjatë periudhës vlerësuese për të rishikuar progresin e bërë siç parashihet me nenin 43 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 7 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, gjegjësisht sipas deklaratës së ankueses deri me datën 03.02.2023 Udhëheqësja e Divizionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare nuk e ka dorëzuar as tek ankuesja dhe as tek Njësia e Burimeve Njerëzore vlerësimin përfundimtar pas komenteve të ankueses.

Po ashtu ankuesja ka kontestuar të gjithë kapitujt e vlerësimit, sepse vlerësimi i rezultateve të punës nga Udhëheqësja e drejtpërdrejtë nuk është real, është tendencioz dhe i pabazuar në prova dhe fakte, sepse mos përfshirja e arritjes së objektivave për ankuesen në bazë të detyrave të punës nuk është bazuar në raportet dhe aktivitetet e saj në punë. Tutje në bazë të provave të lëndës në formularin e vlerësimit për vitin 2022 tek pesë (5) objektivat nuk janë përfshirë të gjitha aktivitetet dhe detyrat e saj të punës, e që është në kundërshtim me nenin 43 paragrafin 1, 2, 3,4,5,6 dhe 7, të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, si dhe duke u bazuar në përmbajtjen e vlerësimit të rezultateve në punë në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcakton se:” 1. Vlerësimi i rezultateve në punë përmban: 1.1. matjen e realizimit të objektivave të përcaktuara - objektivat janë prioritetet e punës së nëpunësit dhe përfshijnë aktivitetet që duhen realizuar deri në fund të periudhës së vlerësuar; dhe 1.2. matjen e sjelljes profesionale të nëpunësit - sjelljet profesionale janë aftësitë profesionale të nëpunësit të treguara gjatë realizimit të detyrave dhe ushtrimit të përgjegjësiive në punë, që përfshinë: 1.2.1. planifikimin dhe organizimin; 1.2.2. vendimmarrjen; 1.2.3. motivimin, zhvillimin dhe trajtimin e paanshëm; 1.2.4. iniciativën dhe kreativitetin; 1.2.5. komunikimin dhe përfaqësimin; dhe 1.2.6. efektivitetin në punë”, andaj vlerësuesi/eprori aktual nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhur me vlerësimin e ankueses për vitin 2022, ka konstatuar se Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses konkretisht Udhëheqësja e Divizionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare, me rastin e vlerësimit të ankueses me notën e përgjithshme 2.5 tek pjesa e komenteve për aftësitë dhe shkathtësitë profesionale, nuk ka shprehur mendimin se pse është vlerësuar ankuesja me këtë notë, gjegjësisht nuk ka shpjeguar as edhe një koment të vetëm lidhur me përmbushjen apo jo të njëres prej objektivave dhe detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në prova dhe fakte të ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses ka vërtetuar se të njëjtat janë pjesërisht të bazuara, andaj Udhëheqësja e drejtpërdrejtë është e obliguar që ankueses ti bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës, në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, dhe nenin 4 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike si dhe të ndërmerre të gjitha veprimet me qëllim që vlerësimi i ankueses të bëhet konformë legjislacionit që rregullon çështjen e vlerësimit të nëpunësve civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave obligon Udhëheqësen e drejtpërdrejtë të ankueses konkretisht Udhëheqësjen e Divizionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare, që të shqyrtoj të gjitha faktet dhe në bazë të gjeturave të këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022 për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022 për ankuesen Arlinda Bajraj, si dhe të gjitha procedurat dhe afatet që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës t'i zhvillojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.420/2023

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Malsore Gashi-BAIRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Administratës Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.